

VENDIM

Nr. 117, datë 17.2.2016

**PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË NJËSITË E
QEVERISJES QENDRORE,
PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2016, si më poshtë vijon:

a) Numri i punonjësve të Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog shtohet me 5 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të institucioneve të tjera qendrore në 326 veta.

b) Numri i punonjësve të administratës së prefekturave reduktohet me 5 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në 14 172 veta.

c) Numri i punonjësve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale shtohet me 16 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Urban në 532 veta.

ç) Numri i punonjësve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) shtohet me 22 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Kryeministrisë në 552 veta gjithsej.

d) Numri i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes reduktohet me 38 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të saj në 9 210 veta gjithsej.

2. Ngarkohen institucionet e përmendura më sipër dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**